



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 382/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Suharekë paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të vendosjes së posterave në rrethojën e objektit publik, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 01.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 1700 (njëmijë e shtatëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 29.10.2013, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga LVV, në të cilën theksohet se me datën 28.10.2013, rreth orës 12:30, në fshatin Savrovë-Suharekë, në rrethojat e shkollës fillore "Iliria" anëtarë të PDK-së, kanë vendosur posterat e kandidatit për kryetar komune, Ramë Vataj dhe kandidatit për kuvendin komunal të Suharekës Ernad Gashi nga radhët e PDK-së, ku me këtë veprim sipas parashtruesit të ankesës janë shkelur neni 33 pika b e LZP-se dhe neni 3.4 i Rregullës 11/2013.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur tre fotografi si dëshmi, për shkeljen e pretenduar.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, me datën 30.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 31.10.2013 në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga PDK, në të cilën theksohet se pretendimet e LVV-së janë pabaza lidhur me shkeljet e pretenduara. Ata shtuan se nga të dhënat nga terreni, në rrethojat e shkollës në fjalë nuk ka të vendosur asnjë shenjë dhe asnjë poster të kandidatit për kryetar të komunës së Suharekës. Këto janë inskenimet aktivistëve të LVV-së dhe se janë bërë me qëllim të dëmtimit të partisë së tyre.

Bashkangjitur më përgjigjen në ankesë PDK, ka dërguar edhe foto për heqjen e posterav në objektin publik.

PDK i propozon PZAP-it që të hedhë poshtë pretendimet e LVV-së

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Sepse me datën 28.10.2013, rreth orës 12:30, në fshatin Savrovë-Suharekë, në rrethojat e shkollës fillore "Iliria" anëtarë të PDK-së, kanë vendosur posterat e kandidatit për kryetar komune, Ramë Vataj dhe kandidatit për kuvendin komunal të Suharekës Ernad Gashi nga radhët e PDK-së, ku me këtë veprim kanë shkelur nenin 33 pika b e LZP-se dhe neni 4.1 pika b Rregullës 11/2013.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se PDK, ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe faktin se posterat e kandidatit për kryetar komune dhe kandidatit për kuvend komunal në Suharekë kanë qenë të vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e posterave. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes, duke i larguar menjëherë posterat nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstatoi se nga ana e PDK-së është shkelur neni 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, pasi që posterat e kandidatit për kryetar të komunës dhe atij të kuvendit komunal nga radhët e PDK-së janë vendosur në rrethojë të objektit publik, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik PDK-së, për evitimin e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

Anr. 382/2013 më datën 01.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*